VENDIM
Nr.1532, datë 19.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KORÇË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të bashkisë Korçë të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 188 (njëqind e tetëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 965 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e pesë).

2.Ngarkohen Ministri e Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Korçës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Korçë Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
28-34,35-45,46-52,54-78,925,927,947,948	Prona që përdoren në fushën e sportit kulturës & monumente historike e kulturore dhe buste me interes vendor.	Në pronësi
79,80,82-451	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtjen civile.	Në pronësi
519-563,949,950,962	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
605,609	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve sociale	Në pronësi
615-618,620-624,627,628,633-634 (vetëm pronat e shërbimit parësor)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin parësor.	Në pronësi
919,920,922	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
686-688,695-844,847-849,852,853,854,855,856,857 861-875,946,956,958,959, 960,961	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
685,877-	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte) dhe	Në pronësi

918,921,923,924,926,929-935,951-955,957,963,964	shërbime publike.	
666,667,671,672	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative.	Në pronësi
637-638 (vetëm kanale të treta dhe toka pa fryt).	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë dhe ushqimit (kanale të treta, tokë inproduktive dhe objekte të ish-NB-së).	Në pronësi
928	Rrjeti i ndriçimit publik.	Në pronësi